



**AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM  
KOSOVO ACCREDITATION AGENCY  
AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA**

Student's Center, 2<sup>nd</sup> floor, 10000 Prishtina, Kosovo, tel. +381 38 213722, fax +381 38 213087  
www.akreditimi-ks.org, email: kaaoffice@gmail.com

Nr. 5421/14 Dt. 04.07.2014

Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Larte (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen XXXI-të të mbajtur më 01.07.2014, duke u bazuar në rekomandimin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit mori:

## V E N D I M

I. Akreditohen programet e studimit të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka":

- Edukim Artistik në Instrumente Frymore / BA (240 ECTS),
- Drejtimi Kushtetues Administrativ / LLM (60 ECTS),
- Teknologji Ushqimore / BSc (180 ECTS),

për periudhën 3 vjeçare, 1 Tetor 2014 - 30 Shtator 2017

II. Programet e studimit:

- Juridiko - Penal / LLM (60 ECTS)
- Menaxhment në Turizëm / MA (120 ECTS)
- Edukim Artistik në Pikturë / BA (240 ECTS)

nuk akreditohen.

## Arsyetim

- III. Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, dhe rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Ndaj këtij vendimi lejohet kërkesa për rishqyrtim të vendimi të KSHC-së brenda afatit të paraparë ligjor.
- V. Institucioni i juaj është i obliguar që të hartojë një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i ekspertëve (në të dy gjuhët, shqip dhe anglisht dhe në të dy versionet, të shtypur dhe elektronik në CD) dhe të njëjtin ta dorëzoni në Agjencinë e Kosovës për Akreditim deri më 30 Tetor 2014.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Universitetit i Pejës "Haxhi Zeka",
- MASHT-it,
- Arkivit

Ferdije Zhushi Etemi, kryetare  
Këshilli Shtetëror i Cilësisë

